



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 123
Prishtinë, më 27 korrik 2010

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 27 KORRIK 2010**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kryetari njoftoi Kuvendin se ndërkohë, në pajtim me nenin 42 të Rregullores, Komisioni për Buxhet dhe Financa, me pëlqimin e Kryesisë, propozon edhe një pikë shtesë:

1. Shqyrtimi i vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës, lidhur me vërejtjet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryetari kërkoi nga Kuvendi miratimin e këtij propozimi me anë të një votimi formal. Kuvendi miratoi propozimin e paraqitur.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i Propozim-Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e PTK-së,
2. Shqyrtimi i vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me vërejtjet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

1. Shqyrtimi i Propozim-Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e PTK-së

Kryetari e njoftoi Kuvendin se Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur dhe Kuvendit i ka parqitur për miratim Strategjinë dhe Vendimin për privatizimin e PTK-së, ndërsa Komisioni parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion e ka shqyrtuar Propozim - Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e PTK-së dhe Kuvendit i kanë rekomanduar të hapet debat lidhur me këtë çështje.

Ai ftoi kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që para deputetëve të prezantojë Strategjinë dhe Vendimin për privatizimin e PTK-së.

Kryeministri **Hashim Thaçi**, tha se sot po shqyrtojmë Strategjinë për privatizimin e 75% të PTK-së, vendim ky i Qeverisë së Republikës së Kosovës i cili është marrë në përputhje të plotë me politikat sektoriale dhe pas një analize gjithëpërfshirëse, në konsultim edhe me trupat këshillëdhënëse ndërkombëtare në Kosovë.

Në vazhdim, potencoi se edhe ne duhet të shkëputemi nga e kaluara centraliste dhe orientimi ngulfatës, siç ka ndodhur në të kaluarën, dhe ta zhvillojmë sektorin privat si mbarë bota demokratike. Privatizimi është jetik për qytetarët e Kosovës, për krijimin e infrastrukturës moderne dhe për krijimin e vendeve të reja të punës, tha ai.

Më tej, theksoi se privatizimi i PTK-së është pjesë e privatizimit të ndërmarrjeve publike dhe është në marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar, të cilët kanë vlerësuar aftësinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për tërheqjen e investitorëve të huaj dhe në këtë drejtim edhe futja e një investitori në PTK do të ketë ndikim në rritjen ekonomike të vendit.

Kosova është vendi i fundit në Evropën Juglindore që i hyn këtij procesi për futjen e kapitalit privat në PTK, ndërsa privatizimi i saj do të ndikonte në parandalimin e dukurive negative, të korrupsionit etj, tha ai.

Në fund, kryeministri Thaçi theksoi se Qeveria e Republikës së Kosovës inkurajon të gjitha kompanitë e huaja që të konkurrojnë për privatizimin e PTK-së dhe i ftoi deputetët për miratim të Strategjisë për privatizimin e PTK-së, në Kuvend, duke u zotuar se të gjitha opinionet, sugjerimet, rekomandimet e Kuvendit do të inkorporohen në këtë strategji.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim-Strategji dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel

Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrime, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Fatmir Rexhepi, Ismajl Kurteshi, Kaqusha Jashari, Riza Smaka, Abdyl Ymeri, Branislav Grbiç, Hydajet Hyseni, ministri Ahmet Shala, Ismet Beqiri, kryeministri Hashim Thaçi, Nekibe Kelmendi, Hajdin Abazi, Bujar Dugolli, Zef Morina, Edita Tahiri dhe Sanije Aliaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e kësaj Propozim-Strategjie. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----42 ,
Kundër----- 4 ,
Abstenime----- 2 .

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet në parim Strategjia e Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e PTK-së.
2. Ngarkohet Qeveria e Republikës së Kosovës që në këtë Strategji t'i inkorporojë vërejtjet dhe propozimet e paraqitura sipas transkriptit të mbledhjes plenare të datës 27 korrik 2010, dhe përmes Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, Kuvendit t'i paraqesë Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim të këtij dokumenti në mbledhje plenare, të sesionit vjeshtor 2010.

2. Shqyrtimi i vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me vërejtjet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryetari njoftoi Kuvendin se Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës është miratuar në mbledhjen plenare, të mbajtur më 12 korrik 2010, dhe i është proceduar për shpallje presidentit të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 84, pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, presidenti e ka kthyer në rishqyrtim Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, ndërsa Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rishqyrtuar Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime, tha ai.

Deputeti **Gani Koci**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa para deputetëve arsyetoi Raportin me rekomandime dhe ftoi deputetët që ta miratojnë amendamentin nr. 1, (amendamentin e vetëm), i cili ka të bëjë me ndryshimin e nenit 41, paragrafi 3 në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pas këtij diskutimi, **Kryetari** e hodhi në votim miratimin e amendamentin nr. 1, i cili ka të bëjë me ndryshimin e nenit 41 paragrafi 3 në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62 ,
Kundër----- 0 ,
Abstenime----- 0 .

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet vërejtja e presidentit të Republikës së Kosovës për ndryshimin e nenit 41 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/ L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Ligji nr. 03/ L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me ndryshimet e miratuara, konsiderohet i shpallur.

Në fund, Kryetari falënderoi deputetët për kontributin e dhënë gjatë këtij sesioni dhe deklaroi të mbyllur Sesionin pranveror për vitin 2010.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:23 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale